

N J O F T I M

për përgatitjen e aktit për shpalljen e një pjese të Malit Sharr si zonë të mbrojtur në kategorinë e parkut kombëtar

1. Emri i Ministrisë: Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor (MMJPH)

2. Problemi: Në përputhje me kërkesat e nenit 92 paragrafi 5 të Ligjit për mbrojtjen e natyrës, u përgatit një Studim për valorizimin e Malit Sharr, i cili duke marrë parasysh bukurinë natyrore specifike, florën dhe faunën e pasur dhe endemike, gjeodiversitetin, karakteristikat hidrologjike dhe vlerat e peizazhit, u konkludua se Mali Sharr i plotëson kriteret për t'u shpallur zonë e mbrojtur e kategorisë II - Park kombëtar.

Bazuar në Studimin, MMJPH përgatiti Informacion mbi nevojën e shpalljes së një pjese të Malit Sharr si zonë të mbrojtur në kategorinë Park Kombëtar dhe ia paraqiti atë për mendim njësisive të vetëqeverisjes lokale, institucioneve përkatëse shtetërore dhe Qeverisë së RMV-së.

Qeveria në Seancën e dyzet e nëntë, të mbajtur më 5 maj, 2020, shqyrtoi dhe miratoi Informacionin, miratoi Vendimin mbi pranueshmërinë e propozimit për shpalljen e një pjese të Malit Sharr si zonë të mbrojtur në kategorinë II - Park Kombëtar dhe e obligoi MMJPH-në të zhvillojë një debat publik mbi propozimin, të përgatisë aktin përfundimtar për shpalljen (Ligji për shpalljen e një pjese të Malit Sharr si Park Kombëtar) dhe të paraqesë propozimin përfundimtar në Qeveri.

3. Qëllimi: Për shkak të vlerave të jashtëzakonshme natyrore, pjesë të malit Sharr janë identifikuar si një nga zonat më të rëndësishme për ruajtjen e natyrës në nivel kombëtar, rajonal dhe evropian. Shpallja e një pjese të Malit Sharr si zonë e mbrojtur në kategorinë Parku Kombëtar do të mundësojë promovimin e mbrojtjes, ruajtjes dhe përdorimit të qëndrueshëm të vlerave natyrore dhe rritjen e sipërfaqes së zonave të mbrojtura në nivelin kombëtar (me rreth 2.1%), pra nga ato aktuale 8.9% në 11%. Kjo do të kontribuojë në avancimin e zbatimit të Objektivave Aichi të Konventës mbi diversitetin biologjik (CBD) dhe konventave të tjera të ruajtjes (Bern, CITES, Bon, Ramsar, etj.), progres në përmbushjen e objektivave dhe veprimeve të Strategjisë kombëtare për ruajtjen e natyrës me Planin aksional për periudhën (2017-2027) dhe Strategjisë Kombëtare të Biodiversitetit me Planin aksional për periudhën (2018-2023), progres në zbatimin e direktivave të BE-së për habitatet dhe zogjtë, avancimi i bashkëpunimit ndërkuftar në fushën e mbrojtjes së natyrës me Kosovën dhe Shqipërinë, zhvillimi i ekoturizmit dhe ekonomisë lokale, etj.

Një pjesë e Malit Sharrit përfshihet në Rrjetin Kombëtar Emerald, i cili buron nga detyrimet e shtetit për të zbatuar Konventën për mbrojtjen e kafshëve të egra dhe habitateve natyrore në Evropë (Konventa e Bernës). Mali Sharr është gjithashtu një zonë potencialisht e ardhshme Natura 2000.

4. Afati kohor për hartimin e aktit:

- Maj 2020 - Vendim mbi pranueshmërinë e propozimit për shpalljen e një pjese të Malit Sharr si zonë të mbrojtur në kategorinë II - Park Kombëtar (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 116/2020);

- Qershor 2020 - Gusht 2020 - takime për shkëmbim të të dhënave me palët e interesuara dhe përgatitja e një versioni të azhurnuar të Studimit të valorizimit të Malit Sharr;

- Gusht 2020 - përgatitja e një Projektligji për shpalljen e Malit Sharr si park kombëtar dhe Raportit mbi vlerësimin e ndikimit të rregullativës;

- Shtator 2020 - Publikimi i Projektligjit për shpalljen e Malit Sharr Park kombëtar dhe Raportit për vlerësimin e ndikimit të rregullativës në faqen e internetit të MMJPH dhe Ener dhe njoftimi për debate publike;

- Nga 9 shtatori deri më 12 tetor - organizimi i takimeve, debateve publike, shqyrtimi i vërejtjeve të paraqitura nga MMJPH dhe grupet e punës dhe futja e vërejtjeve të paraqitura;

- Tetor 2020 - Publikimi i versionit të dytë të projekt tekstit të Ligjit dhe raportit të Vlerësimi t të ndikimit të rregullativës (VNRR) dhe dorëzimi i aktit në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriur për konsultim dhe miratim ndërministror.

.-Nëntor- fillimi I procedures parlamentare

5. Palët e interesuara:

1. Organet e institucioneve shtetërore:

- Ministria e Ekonomisë;
- Ministria e Financave;
- Ministria e Mbrojtjes;
- Ministria e Shoqërisë së Informacionit dhe Administratës;
- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave;
- Ministria e Transportit dhe Lidhjeve;
- Ministria e Punëve të Jashtme;
- Ministria e Kulturës; Zyra për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore
- Sekretariati për Çështjet Evropiane;
- Agjencia e Planifikimit Hapësinor;
- Drejtoria e ekonomisë së ujërave;
- Shërbimi Gjeologjik.

2.Njësitë e vetëqeverisjes lokale

- Komuna e Tetovës;
- Komuna e Tearcës;
- Komuna e Bogovinës;
- Komuna e Vrapçishtit;
- Komuna e Jegunovcës;
- Komuna e Mavrovës dhe Rostushës;
- Komuna e Gostivarit
- Këshilli për zhvillimin e rajonit të planifikimit të Pollogut;
- BNJVL (Bashkësia e Njërive të Vetëqeverisjes Lokale)

3. Ndërmarrjet publike:

- NP për kryerjen e veprimtarive të menaxhimit të ujit hidro-sistemi Zletovica-Probishtip;
- NP Pyjet Kombëtare;

- NP për kullotat.

4. Agjencionet::

- Agjencioni për planifikim hapësinor
- Agjencioni për kataster të patundshmërive të RMV-së
- Agjencioni për pronomovim dhe përkrahje të turizmit

5. Odat ekonomike

- Oda Ekonomike e Republikës së Maqedonisë
- Shoqata e Odave ekonomike
- Oda ekonomike e Maqedonisë Veriperëndimore

6. Shoqëritë aksionare

- SH.A. ELEM Termocentralet e Maqedonisë së Veriut
- ELEM TURS
- SH.A MEPSO- Operator i sistemit elektro-përçues të RMV-së, Shoqëri Aksionare për përçimin e energjisë elektrike dhe menaxhim me sistemin elektro-energjetik dhe
- EVN Termocentralet e Maqedonisë Shkup

7. Organizatat joqeveritare që veprojnë në fushën e mbrojtjes së mjedisit..

6. Mënyra e përfshirjes së palës së interesuar:

- Publikimi i projektaktit për komentimin në faqen e internetit të MMJPH dhe ENER,
- Fushata publike për informimin dhe organizimin e forumeve lokale me partnerë vendorë joqeveritarë,
- Debate publike mbi projekt-aktet ndërmjet 28 shtatorit dhe 9 tetorit 2020 (me njoftim shtesë dhe ftesë për vendet e sakta në media dhe në faqen e internetit të MMJPH) në Tetovë, Tearcë, Gostivar dhe Bogovinë me Vrapçisht, të hapura për të gjithë të interesuarit faqet.
- Kërkonti mendime dhe takime me institucionet qeveritare, njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe komunitetin e biznesit.

7. Adresa e postës elektronike ku palët e interesuara mund të shkarkojnë versionin elektronik të ndryshimeve të propozuara në ligj dhe draft Raportin VNRR:

www.ener.gov.mk
www.moep.gov.mk

8. Adresa dhe / ose adresa elektronike ku mund të paraqiten mendimet, vërejtjet dhe sugjerimet:

infoeko@moepp.gov.mk

9. Personi përgjegjës për kontakt në ministri:

Vlatko Trpeski, Udhëheqës i Sektorit për Natyrën

E-mail: v.trpeski@moepp.gov.mk

Vesna Indova, Udhëheqëse e Sektorit të BE-së

E-mail: v.indova@moepp.gov.mk